

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1860/Prot

Durrës, më: 5.8.2025

V E N D I M

Nr. 69, datë 5.8 2025

PËR

**"MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE PËR
VITIN 2025"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; Vendimit Nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*", Vendimit të Senatit Akademik nr.84, datë 29.07.2025 si dhe në shkresën e Administratorit me Nr. 1819 prot., datë 28.07.2025 "*Kërkesë për rialokim fondesh, për vitin 2025*", relacioni i Drejtorisë së Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në përdorimin e të ardhurave, për vitin 2025, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 1819 Prot., datë 28.07.2025 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

